

## Qendra e Informacionit për Kosovën

Strombergstraße 11  
70188 Stuttgart  
Telefon: 07 11 / 26 33-11 79 (Silke Liria Blumbach)  
Telefax: 07 11 / 26 33-14 61  
E-mail: Caritasverband-Infozentrum@T-online.de

# Fleta informative Kosova 9

26.09.2000

### Lëshimi i dokumentave të UNMIK-ut (Burimi: Fletë udhëzuese e UNMIK-ut)

Administrata e përkohshme e Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) në përgjithësi po lëshon dokumenta të gjendjes civile për persona nga Kosova. Megjithatë, momentalisht lëshohen vetëm dokumenta për ata persona të cilët mund të vërtetojnë identitetin e tyre duke paraqitur një pasaportë jugosllave ose një letërnjoftim jugosllav. Pasa-porta ose letërnjoftimi pranohet nga UNMIK-u edhe në qoftë se i ka kaluar afati. Sa u përket kosovarëve që jetojnë në të huaj, mjafton t'i paraqesin UNMIK-ut një kopje të vërtetuar të dokumentit identifikues. Prej datës 15 shtator kërkohet një tarifë prej DM 25 për çdo dokument të lëshuar.

Për të marrë një **certifikatë lindjeje (zëvendësim)**, duhet të na dërgohen, përveç pasaportës ose letërnjoftimit, një kopje e vërtetuar prej certifikatës së vjetër (jugosllave) të lindjes, ose të dhënat e sakta për prindërit e kërkuesit / kërkueses, dmth. mbiemri dhe emrat e prindërve, mbiemri i vajzërisë i nënës, datëlindjet dhe vendlindjet e prindërve dhe vendbanimi i tyre në çastin e lindjes së kërkuesit / kërkueses.

Për të marrë një **vërtetim beqarie**, duhet të na dërgohet, përveç pasaportës ose letërnjoftimit, një deklaratë me be e vërtetuar noterisht që është dhënë prej dy dëshmitarëve që e njohin personalisht kërkuesin / kërkuesen dhe që vërtetojnë se ai / ajo është beqar/e përkatësisht i / e divorcuar përkatësisht i / e ve. Kjo deklaratë duhet të përmbajë mbiemrat, emrat, datëlindjet, vendlindjet, numrat e dokumentave identifikues si dhe adresat e dëshmitarëve dhe të kërkuesit / kërkueses. Kopjet e dokumentave identifikues të dëshmitarëve duhet t'i mbërthehen deklaratës. Në qoftë se kërkuesi / kërkuesja është i / e divorcuar, atëherë duhet të marrim gjithashtu një kopje të vërtetuar të vendimit gjyqësor të divorcit, dhe në qoftë se ai / ajo është i / e ve, atëherë duhet të marrim një kopje të vërtetuar të certifikatës së vdekjes të partnerit.

Për të marrë një **certifikatë martesë (zëvendësim)**, përveç paraqitjes së pasaportës ose të letërnjoftimit duhet të marrim të gjitha informatat e disponueshme, dmth. mbiemrin (për gruan edhe mbiemrin e vajzërisë), emrin, datëlindjen, vendlindjen e partnerit, datën dhe vendin e martesës. UNMIK-u mund të lëshojë një zëvendësim të certifikatës së martesës vetëm në qoftë se regjistri përkatës i martesave ekziston ende në komunën përkatëse.

Për të marrë një **certifikatë vdekjeje (zëvendësim)**, përveç paraqitjes së pasaportës ose të letërnjoftimit duhet të marrim të gjitha informatat e disponueshme, dmth. mbiemrin, emrin, datëlindjen, vendlindjen, datën e vdekjes. UNMIK-u mund të lëshojë një zëvendësim të certifikatës së vdekjes vetëm në qoftë se regjistri përkatës i vdekjeve ekziston ende në komunën përkatëse.

**Të gjitha vërtetimet duhet të na paraqiten në origjinal. Në raste urgjente mjafton një kopje faksi në qoftë se origjinali do të na dërgohet menjëherë.**

Adresa postare e UNMIK-ut është:

UNMIK  
Civil Documents Section, Prishtina HQ  
P.O. Box 515 ose 596  
91000 Shkup  
MAQEDONI

Numri i faksit është: 001 212 9638 603 (Attn. Verena Dittmar, Ext. 5759)